



**Fashikulli 6.B.**



# Rregullimi i investimeve dhe zhvillimi durabël

**Rritja e paparë e investimeve e drejtuar drejt vëndeve të huaja (IDE) që është një fenomen çelës i procesit të mondializimit të ekonomisë, për disa paraqet një shpresë drejt zhvillimit durabël. Këto investime lejojnë transferta teknologjike dhe financiare të rëndësishme. Por kur ka një mungesë të rregullave ndërkombëtare disa firma me pak skrupuj kanë mundësinë të shfrytëzojnë burimet natyrore dhe humane të vëndeve në zhvillim.**


## 1. A ESHTË NDIHMJA PRIVATE NJE ZEVENDESUESE E NDIHMES PUBLIKE ?

**Flusket private zëvendësojnë ndihmat publike...** Menyrat e financimit të zhvillimit kanë ndryshuar. Në mesin e viteve 80 pjesa më e madhe e burimeve që i drejtohehin vëndeve në zhvillim përbehehin nga financime publike. Sot pjesa e sektorit privat kalon në mënyrë të dukshme financimet e sektorit publik: gjithmonë e më shumë duket se ndihma private është një alternative e ndihmes publike. Pas një rënie të dukshme në vitet '80 ndihme private është rritur vullshëm në vitet '90. Me 1992 pjesa e kapitaleve private në investimet në vëndet në zhvillim është bërë më e madhe se investimi publik. Por kirza financiare e vitit 1997 në Azinë Lindore pati si pasojë një ulje të nivelit të kapitaleve private (206 miliardë dollarë në vitin

1997 kundrejt 286 miliardë dollarë në vitin 1996).

... por privilegjojnë Azinë lindore dhe Amerikën Latine. Ndihma private merr formën e huave dhe granteve në kushtet e tregut të financuar nga sektori privat: investimet direkte kuota e detyrueshme, kredite mbi eksportet, investimet dypaleshe ose shumëpaleshe të portofolit etj. Kjo lloj është ndihmë shumë përzgjedhese në zgjedhjen e paleve dhe të sektoreve të investimit: Amerika Latine dhe Azia përbëjnë pjesën më të madhe të destinacioneve të kesaj ndihme duke mos mbështetur kështu zona të tjera siç janë Afrika dhe lindja e Mesme. Vëndet me të vogla dhe me pak të zhvilluara duket se nuk arrijë akoma të terheqin interesin e këtyre kapitaleve që janë burime potenciale të financimit të zhvillimit. Nga ana tjetër, burimet private nuk shkojnë në disa sektore thelbësore, nevojat për të cilat janë prioritare siç janë shëndetësia dhe shkollimi.

## Financimet e zhvillimit: Zhvillimi i flukseve publike dhe i flukseve private





## 2. PROJEKTET E MARREVESHJES SHUMEPALESHE MBI INVESTIMET (AMI)

**Përgatitja e AMI nga OCDE.** Deri tani kemi një numer të madh marrëveshjesh dhe konventash dypaleshe mbi investimet. Në nivel shumëpalesh, një marrëveshje mbi investimet lidhur me tregëtinë është përpunuar nga OBT. Pas një mbledhje të ministrave në maj të 1995 Organizata e Kooperimit dhe Zhvillimit Ekonomik (OCDE) që mbledh 29 vëndet me të pasura të botes filloi negociatat që synonin të krijonin një marrëveshje shumëpaleshe mbi investimet (AMI). Vëndet e OCDE mbajnë një peshe për 85 për qind të fluksit të IDE drejt vëndeve të huaja dhe 65 për qind të kapitalave si vënde destinatore. OCDE nënvizoi që në fillim të negociatave se vëndet jo anëtare të OCDE edhe pse ishin të përjashtuara në negociata mund të merrnin pjesë në AMI.

**Të liberalizosh më shumë se sa të rregullosh.** Projekti i OCDE "synon t'i japë investimeve një mbrojtje me të mirë ndaj shpronësimeve dhe kundra masave të tjera arbitrare, të ndërtojë mekanizmat të rregullimit të diferencave, mbrojtje e investuesve dhe për të krijuar një teresi unifome rregullash që kanë synim mbrojtjen e investitotreve dhe mundësinë e futjes së tyre në treg të cilat nuk janë aktualisht të integruara në traktatet dypaleshe mbi investimet". Harmonizimi i rregullave që drejtojnë IDA proçes i nxitur nga OCDE ka për objektiv të eliminojë në mënyrë objektive veprimet diskriminuese të disa qeverive përballë ndërmarjeve shumëkombeshe, në mënyrë që hyrja në treg për këto të fundit të behet me të njëjtat kushte për firmat e huaja si për firmat kombëtare. Në këtë drejtim objektivi i AMI qëndron para se gjithash që të liberalizojë investimet se sa të krijojë një kuader rregullimi për këto të fundit. Studimit të projektit të përpunuar nga OCDE përballet me këtë problem.

### A. Arkitektura e AMI

#### Tre shtyllat themeltare

① Detyrimet e shteteve. Ami përdor një seri parimesh të frymëzuara nga Gatt objektivi i të cilave është të liberalizojë dhe të mbrojë. IDE (klauzola e vendit me të favorizuar parimi i trajtimit kombëtar transparenca) të cilave duhet të nënshtrohen shtetet siç është për shëmbull rregullorja për shpronësimet.

② Përjashtimet. Për arsye të brendshme shtetet mundet të kenë rezeva në sektore të ndryshëm të ekonomisë ose për mekanizma kombëtare ku ata nuk deshirojnë që të aplikohin rregullat e Ami (përjashtim për sektorin e kultures).

③ Mekanizmat e rregullimit të diferencave. Me ndikim të fortë nga i njëjti rregull që është në fuqi në OBT ai themelon një instancë arbitrimi të diferencave që mund të lindin n.q.s. një investues vlerëson p. sh; që rregullat në fuqi në një vend

nuk respektojnë rregullat e Ami pa qënë objekt i përjashtimeve të diskutuara.

**Krahasimi AMI OBT.** Projekti Ami duke i ngjashem me atë që çoi në krijimin e OBT, por ai shtyhet me tej se ky i fundit në atë që quhet rregullorja e diferencave dhe përjashtimeve:

■ Rregullorja e diferencave. Në OBT ky rregullim behej midis shteteve, kurse tani AMI i lejon të ballafaqohen në mënyrë direkte investitorët me shtetet.

■ Përjashtimet kombëtare. Në OBT sektoret ekonomike nuk i janë nënshtruar një marrëveshje. Duhet kryer një proçes i veçantë për t'i integruar. Në AMI është rruga e kundër që mbizoteron. të gjithë ata sektore të cilët nuk janë cituar në mënyrë të drejtpërdrejtë si rezerva janë pjesë përbërëse e marrëveshjes. Duhet kryer një proçes i veçantë për të gjithë ata sektore që nuk përfshihen. Nga ana tjetër AMI ka një mekanizëm të veçantë që quhet masa klik-klak që ka të bejë me pamundësinë e rishqyrtimit të një rezerve kur kjo e fundit është egzistente dhe që në këtë mënyrë pengon kalimin drejt një stadi me të lartë liberalizimi.

■ Prejashtimet e prekorsionit. Në OBT objektivat sasiore të uljes progresive të të drejtave doganore që shtetet marrin përsipër të respektojnë sipas marrëveshjeve të Gatt mund të jenë shumë më superiore se të drejtat reale të cilat përbëjnë një siguri për vëndet nënshkruese. Në kuadrin e Ami niveli i pjesëmarrjes së huaj në një nivel të dhënë i fiksuar nga një shtet duhet të korrespondojë minimumit të takses në fuqi në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes. Pasi marrëveshja është nënshkruar shtetet nuk do të kenë me "marsh manovre" që mund t'i shrbëjë atyre për të ulur pjesën e huaj të investimeve në industrinë në fjalë.

**Mbrojtja totale.** Nga ana tjetër në kapitullin "Detyrimet e rrezultateve" AMI parashikon një varg mekanizmash shtesë për të siguruar mbrojtjen totale të investuesve. Asnjë shtet nuk mund të detyrojë investitorët të respektojnë një nivel përmbytjeje me elemente kombëtare në prodhimet e tij (të integrojë një përqindje me të mirave të prodhuara në zonë ose shtet, në zinxhirin e prodhimit, dhe të transferojë teknologjinë ose të krijojë qëndren lokale në token e tij). Investuesi është gjithashtu i lire të riatdhesojë të gjitha fondet dhe përfitimet jashtë territorit ku ka investuar pa pengesë.

### B. Ami përballë zhvillimit durabël.

**Tre pika specifike.** OCDE mendon se Ami siguron një trajtim të mjaftueshëm të zhvillimit durabël në tre pika:

① Ky i referohet principeve të mjedisit dhe social por që nuk kanë asnjë forcë kundërshtuese. Ai do të merret prasysh gjatë rregullimit të diferencave.

② Klauzola e mos nxjerrjes jashtë ligjit të normave. Sipas principit të mos diskriminimit,



legjislacioni mjedisor duhet te aplikohet në mënyrë uniforme në të gjitha ndërmarjet, te huaja ose kombëtare. Ketu behet fjale që nga njëra anë të lufohet ndaj „dumping“ social dhe mjedisor dhe nga ana tjetër për të fiksuar një legjislacion dysHEME, duke njohur superioritetin e te drejtes ndre kombëtare mbi ate kombëtare. Megjithatë, efikasiteti i këtyre klauzolave varet nga forca detyruese ae ajo ka. Duke qënë se shumica e vëndeve janë kundr klauzolave detyruese mundet ae te këtë një terheqie te përgjitheshme ndaj masave mjedisore, ae do te thote një pezullim i marrëveshjeve kur behet fjale përçështjë te mjedisit dhe te shëndetit publik. Por ky aendrim nuk është i pranuar nga te gjitha palet.

③ Anekset. Parimet detyruese drejtuar për shumëkombeshet në fushen e mbrojtjes sociale dhe mjedisore mund te aneksohen nga Ami. Këto parime reference do te tregojnë rrugen për të mbijetuar dhe do te nxitnin shoqatat transkombëtare te rritnin rrespektin ndaj mjedisit dhe te përhapjes se teknologjive te pastra. Por edhe si për... këto parime nuk kanë forcë juridike shtrenguese.

**Sadifaksioni OCDE.** Sipas OCDE, këto pika kushtezojnë një integrim pozitiv te shqetesimeve mjedisore me rregullimin e investimeve. Kështu liberalizimi i investimeve do te lejojë dhe favorizojë rritjen ekonomike globale dhe kështu te mirëqënies: te ardhurat shtesë te nxjerra nga rritja ekonomike mund te rinvestohen në përmiresimin e kushteve te jeteses, mbrojtjes se mjedisit.

**Kritikat e OJQ.** Shumica e OJQ-ve që kundërshtojnë totalisht AMI theksojnë se marrëveshja nuk merr parasysh parimet e mareveshjes se Rios. Ato shqetesohen për efektet sociale dhe ekologjike te liberalizimit te investimeve dhe i vjen keq që negociuesit e projektit nuk i janë përgjigjur veçse në mënyrë te pjeseshme shaetesimeve fillestare. OJQ-te mendojnë se konkurenca drejt investimeve gjithmonë në rritje do te shtyjë shtetet te fshijnë normat mjedisore dhe sociale me qëllim thithjen e investimeve. një klauzole jo shtrenguese për mos uljen e nivelit te normave mjdisore nuk mund ta ndalojë këtë proçes. Për OCDE kjo rrjedhe ngjarjesh duhet te jete pak e mundeshme, sepse politikat e mjedisit i përgjigjen një kërkese sociale te forte, te cilen në nuk mund ta injorojme. Si rrjedhojë e kostove te ulta mjedisore te marra përsipër nga ndërmarjet (1-2 për qind) OCDE mendon që kërkesat në fushen e mjedisit nuk luajnë një rrol thelbesor në zgjedhjen e lokalizimit te investitoreve përveç se ndonjë sektori te veçantë. OCDE shton se IDE janë kanale transmetimi dhe përhapjë për teknologjite e pastra që është me përfitim për firmat shumëkombeshe te aplikojnë proçese uniforme prodhimi midis qëndres dhe filialeve.

**Konflikti AMI-Mjedis.** Nga ana tjetër kanë dale në drite shumë papëruethshmeri midis

instrumentave te politikës mjedisore dhe mekanizmeve te Ami. Kështu normat kombëtare që ndryshojnë sipas aktivitetit te një ndërmarjë ose vendi instalimi, mundet te përbëjnë një forme diskriminimi midis investitoreve kombëtare dhe ndërkombëtare (rast i zonave te klasifikuara në Francë). Shëmbull: një shtet që deshiron te ruajë ekuilibrin e stokut te peshqve mund te vendose te ule stokun total te kapjeve për ndërmarjet e vendit dhe te huaja. Firmat e huaja mundet që sipas Ami te konsiderojnë këtë uljë kuote si një shpronësim direkt. Mundësia e vetme për të evituar këtë rast do te ishte që të gjithë vendet bregdetare do ta konsideronin peshkimin si një përjashtim nga rregullat e përgjitheshme te Ami. Së fundi marrëveshjë vullnetare siç ajo që u nënshkrua nga ndërmarja Amerikanë INTEL dhe agjensise amerikanë te mjedisit APE që ka te bejë me një kontrate që e lejon INTEL te evitojë mekanizmat e komplikuara pe t'ju përshtatur normave amerikanë mbi ndotjen e amerikan (Clean Air Act) për uljen e nivelit te hedhjeve atmosferike mundet te ndikojë në reagimin e ndërmarjeve te huaja ndaj qeverise amerikanë nëse kjo e fundit nuk do te jape te njëjten mundësi.

### **Rregullat e shpronësimit: të gjithë te drejtat për investitorët, të gjithë detyrimet për shtetet.**

Ami konsideron se ka shpronësim në momentin kur një ndryshim i legjislacionit kombëtar çon në privimin e një pjese ose te të gjithë përfitimeve te investitoreve. Ky mekanizem i Ami është bazuar në një rregull te ngjashem te marreveshjes se kembimit te lire amerikano veriore (ALENA) që është kryer midis Meksikes, Kanandase dhe SHBA. Ky mekanizem që mund te përdoret nga firmat vlerëson që një ndryshim i ligjeve mjedisore ose sociale te një vendi do te dëmtojë firmat nga ana financiare duke mos qënë kështu një rast shëmbull.

Në korrik 1998 qeveria kanadeze vendosi te heqe ndalimin e importit te benzinës që përmban një lëndë shtesë (MMT) e cila deri atëherë ishte quajtur toksike. Firma amerikanë Ethyl Corporation kishte filluar para disa muajve një proçes juridik kundër qeverise kanadeze duke dashur te vertetojë se ky ligj ishte kundër rregullave te ALENA dhe që përbënte shpronësim. firma amerikanë ishte efektivisht furnizuesi i vetëm i Kanadasë me MMT. Ethyl Corporation kërkonte një dëmshpërblim prej 250 milion USD dhe interesat nga qeveria kanadeze për padrejtesinë e kryer. Por heqja e emargos kanadeze dhe një marrëveshjë dypaleshe me një dëmshpërblim prej 13 milion USD e ndaluan proçesin gjygesor, maegjithate ajo ngriti probleme te tjera. një tjetër firme amerikanë S.D. Myers ka bërë te ditur qëllimin e saj për të kërkuar një dëmshpërblim prej qeverise kanadeze për



një ndalim importit mbi një tjetër një lëndë tjetër toksike PCB nga nëntori i 1995 deri në shkurt të 1997.

Projekti Ami mund të zhvillohet lidhur me probleme të ngjashme që kapen pa marsheve të manovres të shteteve në fushën e mjedisit dhe veçanërisht kur bëhet fjale për të marrë masa mbrojtëse. OJQ e përdorin gjërësisht këtë argument në fushatat e tyre kundër Ami. Ate tregojnë gjithashtu se jo diskriminimi i afishuar nga Ami është një bllof. një firmë e huaj mundet të „sulmojë“ një shtet kurse një firmë kombëtare e ka të vështirë ta bëjë këtë.

### C. Dështimi i negociatave

**Konflikti SHBA-BE.** Në gjirin e OCDE debati me i ashpër u krye midis BE dhe SHBA. mosmarrëveshjet qëndrojnë në disekuilibrat e cilësisë së ofertes së BE dhe SHBA. BE i shqetesuar për të ruajtur një problem social dhe kulturor (se paku disa shtete si Franca pohojnë të jenë zona me pak diskriminuese për investuesit e huaj krahasuar me ata vendas. Në SHBA egzistojnë më shumë se 400 ligjë të cilat bien ndesh me marrëveshjen (subvencionet e drejtuara për nga ndërmarrëjt me kapital amerikan, tregjë publike të ndretuara sipas kombesive) ky kundërshtim frenoi nënshkrimin e Ami.

**Mobilizimi i OJQ-ve.** Gjatë negociatave një mobilizim i paparë i OJQ-ve bllokoi diskutimin. asnjë marrëveshje tjetër me drejtim ekonomik nuk kishte shkatuar ndonjëherë kaq shumë kundërshtime dhe tensionë në gjirin e shoqërisë civile. Organizimi i kundërshtimeve, përhapja ndërkombëtare, forca dhe shpejtësia e zhvillimit i gjeten negociuesit të papërgatitur. Gjithmonë e më shumë të zgjedhurit e vëndeve të ndryshme mbështeten veprimet e OJQ-ve. Kështu parlamenti European votoi një rezolute kundër Ami.

**Lënia mënjanë e projektit.** Gjatë mbledhjes së grupit të negociatave në prill '98 debatet zyrtare u shtynë për gjashtë muaj si pasojë e kundërshtimeve gjithmonë në rritje të OJQ-ve në planin botëror dhe rritja e listës së përjashtimeve të paraqitura nga vëndet të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe shumë qeveri filluan procedurën verifikimi në shoqërinë civile. Njëra prej tyre e çuar përpara nga deputetja europiane Catherine Lalumière për llogari të qeverisë franceze çoi në terheqjen e qeverisë franceze nga negociatat. me rastin e mbledhjes së fundit të organizuar me 4 dhjetor 1998 OCDE propozoi përfundimisht projektin e saj Ami duke vlersuar se negociatat “nuk kanë aresye të egzistojnë”.

#### Dështimi Ami.

Pjesë e nxjerrë nga raporti Lalumière: «Ami nxjerr në pah një problem thelbesor të cilit duhet ti dalin përpara qeveritë në

administrimin e maredhenieve midis ekonomive të hapura por sovraane: si të rrgullosh raportet detyrimet e shteteve me nevojat e ndërvaresise pa i vënë atyre detyrime të panevojshem aë do të kishin si rrjedhim një kundërshtim për hapjen nga ana e opinionit publik? (...) Kur bëhet fjale për investimet e huaja ne duhet të pyesim vetën nëse mund të arrijme objektivat e liberalizimit nëpërmjet një marrëveshje me të thjeshtë dhe me pak të dëmshme për sovranitetin e shtetit sepse bazohet në principin e parimit të lire dhe jo diskriminimit.

Në logjikën tonë është pozitive por rruga është shumë e vështirë. Ajo prjashton si vazhdimësinë totale dh të plotë të tekstit aktual por gjithashtu edhe zgjerimin e tij. Negocimi duhet të fillojë- nëse kjo është e mundur- por mbi baza të reja për të bërë një marrëveshje të re.

Ajo që duhet të evitohet të rrifillohen negociatat mbi bazat aktuale. Është tendenca e sektariatit të disa delegacioneve që të fillojnë aty ku e kanë lënë. Është e qarte që opinionin publik francez nuk do ta pranonte ate. Nga njëra anë do të ishte e pamundur për të arritur në këto raste që të riekulibrohen leshimet që kërkojnë ndërmarrjet dhe nga ana tjetër kundërshtimi do të ishte gjithmonë e më intensiv. Te vazhdohen negociatat aktuale duket se nuk është as e mundur as dëshiruar

Të shtosh amendamente në tekstin aktual pa ndryshuar arkitekturen. Disa përmiresime janë të domosdoshme mbi klauzolat sociale mjedisore dhe në kulture (...) por këto rregullime do të jenë të pamjaftueshme për të ulur kundërshtimet që i janë bërë AMI-it.»

**Një embrion i shoqërisë civile botërore.** Ami është shënuar në historinë e negociatave ndërkombëtare si një eveniment i rëndësishëm. Në 1992 në Rio disa mijera OJQ tentuan të organizoheshin për të përcaktuar pozicionet dhe mjetet e veprimit të përbashket, gjashtë vjet me vonë, për herë të parë një „shoqëri civile botërore“ e përfaqësuar nga OJQ-t e shumë vëndeve, komunikuan përtej kufijve kombëtare dhe prodhuan një diskutim koherent dhe homogjen në çështjet e medha ekonomike ndërkombëtare.

**Vendi i internetit.** Zhvillimi i internetit ka dhënë një ndihmese të madhe në këtë drejtim. Ai lejon përhapjen e menjëherëshme të teksteve zyrtare sekreti i të cilave është gjithmonë e më shumë i pamundur, përhapjen e sintezave pedagogjike dhe kritikave të tyre dokumentave. Sybjekti i negociatave ekonomike megjithse se shumë teknik mundet tashmë të zberthet nga grupe ekspertesh që bashkëpunojnë me OJQ (juriste ekonomiste etj.). Kjo punë bën të mundur marrjen e një pozicioni të argumentuar në planin



juridik dhe për t'i përhapur në bote nëpërmjet rrjeteve elektronike. Ky zhvillim është i pakthyeshem dhe shoqëria civile do të vulosi me vulen e saj negociatat ekonomikedhe në mënyrë të veçantë pasuesin e Ami.

**Pasiguria përballë mondializimit.** Gjerësia e kundërshtimeve të Ami ka zbuluar një pasiguri të thellë të shoqërisë civile përballë globalizimit. Nuk është vetëm përmbajtja që ka patur kritika por edhe metoda e negociatave ka patur probleme. Diskretitimi i negociatave mungesa e demokracisë dhe zgjedhja e shoqërive të cilave u drejtohen Ami janë pikat të cilat forcojnë mobilizimin e OJQ-ve. Kushdo qoftë vendi i negociatave të Ami të ardhshme, OJQ-te nuk do të tolerojnë një marrëveshje aq jo simetrike si ajo që u propozua nga OCDE, e cila i jep të gjithë të drejtat shumë kombesheve dhe të gjithë detyrimet shteteve, të gjithë të drejtat vëndeve që investojnë dhe të gjithë detyrimet vëndeve pritese të këtyre investimeve që realisht janë vendet e varfëra duke mos i lënë zgjidhje tjetër vëndeve në zhvillim.

#### D. Një marrëveshje e re?

*Një nevojë e pakundërshtueshme.* Megjithatë këtë deshtim shumë zëra kujtojnë se rritja e IDE është një logjike e pakthyeshme dhe që për rrjedhojë duhen të vendosen rregulla shumëpaleshe për të ulur efektet negative të investimeve dhe për të maksimizuar efektet pozitive. Objektivi i përgjithshëm që ka të bëjë me rregullimin e investimeve të huaja është pak i kundërshtuar. Disa mendojnë se një marrëveshje e tillë të bëhet dallimi i flukseve financiare me karakter spekulativ me investimet direkte, të cilat janë shumë me të qëndrueshme dhe motorre të mundeshëm të zhvillimit durabël, por n.q.s. parimi i një marrëveshje të re është pranuar, arkitektura dhe modelet e negociatave paraqesin probleme.

**Të transferojmë negociatat në kuadër të OBT?** A do të bëhet hapja e një procesi negociati për liberalizimin e investimeve nga ana e OBT? Ky transferim nuk mund të zyrtarizohet vetëm përgjatë konferencës së ardhshme të ministrave që do të shenojë fillimin e ciklit të ardhshëm të negociatave tregëtare shumëpaleshe (milenium raund) nga 30 nëntori-3 dhjetor 1999 në SHBA. OBT paraqet avantazhin të përfaqesojë 132 shtete (kundrejt 29 që ka OCDE). Nga ana tjetër mekanizmat e rregullimit të diferencave kanë të bëjnë vetëm me shtetet dhe jo me sektorin privat. Vendet e zhvilluara mendojnë të aplikojnë këtë metode të mbështëtura nga disa lobe industriale por të hedhura poshtë nga vendet në zhvillim dhe OJQ-te. OBT gëzon reputacionin e një institucioni i cili është pak i ndjeshëm ndaj çështjeve sociale dhe mjedisore. Kalimi në OBT mund të krijojë pakenaqësi edhe pa ridiskutuar pikat e hedhura nga OCDE dhe pa u futur në

marrëveshje disa kërkesa të shoqërisë civile, Ami do të ketë vështirë të vihet në jetë.

**Propozimet e raportit Lalumicre.** Raporti Lalumicre ka parashikuar të bëjë disa ndryshime radikale të tekstit fillestar. Sipas këtij raporti objektivi i marrëveshjes së ardhshme duhet të jetë krijimi i një kuadri ndërkombëtar jodiskriminues dhe që nuk ve në dyshim sovranitetin e shteteve. Ky kuadër duhet të bazohet në dy parime të OBT të cilat janë; Trajtimi kombëtar (që detyron çdo vend të mos bëjë diskriminime në territorin e tij kombëtar midis anëtareve kombëtar dhe atyre të huaj) dhe klauzola e vendit më të favorizuar (që obligon shtetet të kryejnë një trajtim identik të të gjithë aktoreve ekonomike të huaj pa dallim kombesie). Këto dy principet mund të jenë objekt përjashtimesh përse i përket politikave kulturore.

**Shtatë kushtet e suksesit.** Autorët e raportit vlerësojnë që tenikisht një marrëveshje e re mund të arrihet n.q.s. egziston vullneti politik dhe n.q.s. të gjithë mekanizmat që kufizojnë sovranitetin e shtetit dhe që i vendosin detyrime «absolute» përtej ndalimit të jo diskriminimit do të hiqen dhe në rast se disa kusht do të rreprektohen.

1 Kufizimi i kushteve të marrëveshjes së IDE d.m.th. përjashtimi i operacioneve spekulative në tregjet financiare.

2 Të hapen mekanizmat e rregullimit të diferencave vetëm për shtetet dhe jo për investitorë. Kjo do të lejonte t'i përgjigjeshim kritikës sipas se ciles Ami i shërbën interesave të ndërmarrjeve të mëdha që kanë mjetet për të kryer betejat juridike.

3 Heqjen e nenit që synonte të sigurojë një (mbrojtje tërësore dhe kostante) për investitorët e huaj.

4 Heqja e nocionit (masa me efekt të njëjtte për një kombëtarizim ose shpronësim që lejojnë interpretimin e legjisllacionit publik duke ulur vlerën ekonomike të një investimi të huaj si një shpronësim.

5 Ulja e listës së masave të ndaluara në fushën e detyrimeve të rezultateve.

6 Heqja dore nga klauzola "klik-klak" që bën të pakthyeshme të gjithë masat e liberalizimit të ndërmarrja nga një qeveri. Zevëndësimi i kesaj klauzole me një mekanizëm "jo forcimi" që i lejon një vendi siç ndodh në OBT të rishqyrtojë një angazhim duke kompensuar partneret e tij tregëtare.

7 Të nxisin një pjesëmarrje efektive të vëndeve në zhvillim dhe të arrijnë nënshkrimin final të një numri të mjaftueshëm të një numri vëndesh për antaresim.

**OJQ-te për një debat të madh publik.** A do të jenë këto kushte të mjaftueshme për të q tesuar kundërshtimin e OJQ? Këto të fundit kanë një mendim krejt tjetër. Kalimi i dosjes së Ami pranë OBT e cila kritikohet rëndë prej tyre për mungesë të transparencës dhe neglizhim të aspekteve thelbësore të zhvillimit durabël që është mbrojtja



sociale dhe mjedisore, shihet me sy negativ nga OJQ te cilat i kosiderojnë çështje ideologjike dhe politike: është e rendeshishme t'i thuash jo AMI dhe liberalizimit te eger por edhe te besh propozime pa renë preh i rrymave regresive (kombëtarizimit).

OJQ tentojnë tashmë te përcaktojnë kushtet që do te lejojnë investimet te kontribuojnë në zhvillimin durabel. Cilat do te jenë rregullat sociale, mjedisore dhe demokratike te cilat te vendosura në qëndër te mekanizmit duhet te shërbëjnë si baze për të gjithë marrëveshjet për investimet? për të studiuar me gjërësisht këto çështje ato kërkojnë ndërtimin e një

memorandumi mbi rregullimin e investimeve dhe janë kundër marrjes se dosjes se AMI nga OBT. Ky memorandum do te lejojë një pasqyrim te kërkesave te qytetareve dhe zgjedhjet e shoqërisë. OJQ vlerësojnë të domosdoshme futjen e klauzolave shtrenguese përta i përket uljes se normave ekologjike dhe sociale si dhe për parimet drejtuese te cilave duhet t'i nënshtrohen firmat shumëkombeshe. Së fundi ato theksojnë rendesinë e një kontrolli demokratik: të gjithë diskutimet e medha te marra nga institutet ndërkombëtare duhet te jenë objekt i një objekti politik në parlamentet kombëtare.